



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 23 gusht 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë K O M I S I O N I T P Ë R S H Ë N D E T Ë S I, P U N Ë D H E M I R Ë Q E N I E S O C I A L E

Në mbledhje morën pjesë: Nazane Breca, Time Kadriaj, Bahri Thaçi, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi dhe Flora Brovina.

Munguan: Salihe Mustafa dhe Fikrim Damka.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- Administratore e Komisionit dhe Enis Halimi – Zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Time Kadriaj, nënkryetare e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.07.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.07.2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale pa vërejtje miratoi procesverbalin e datës 11.07.2012

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Time Kadriaj- Tha se këtë projektligj e kemi miratuar në sesionin pranveror. Siç po e shihni, Komisioni për legjislacion ka bërë një vërejtje për amendamentin 3. Personalisht mendoj se, pasi që rregullorja e re ende nuk është miratuar, duhet ta miratojmë ashtu siç kemi propozuar si Komision.

Nazane Breca- Deklaroi se ky projektligj duhet të miratohet ashtu siç e kemi lënë në sesionin e kaluar, pasi që ende nuk është miratuar rregullorja e re.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri e miratoi Raportin përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

4. Të ndryshme

Liburn Aliu- Tha se duhet ta caktojmë një mbledhje të grupit punues për monitorimin e Ligjit të punës. Ne do ta hartojmë një draft- raport, të cilin ne së bashku do ta diskutojmë. Pastaj do ta kemi një takim edhe me përfaqësuesit e MPMS.

Time Kadriaj- Tha se ne duhet të punojmë në mënyrë të pavarur nga MPMS dhe nuk ka nevojë të takohemi me ta për hartimin e këtij raporti. Edhe nëse vjen propozimi për ndryshimin e ligjit nga MPMS, ne e kemi fjalën e fundit si legjislativ dhe forma finale e ligjit varet përsëri nga ne.

Flora Brovina- Deklaroi se nuk është në rregull që të dëgjojmë nga ministri i MPMS që duhet të ndryshohet ligji në nenin ku ka të bëjë me pushimin e lehonisë. Duhet të këmbëngulim në mbrojtjen e lehonave. Ne, gjatë monitorimit, nuk kemi dëgjuar ndonjë ankesë lidhur me pushimin e lehonisë. Kemi një shkallë të lartë të mortalitetit dhe morbiditetit të lehonave dhe fëmijëve. Edhe ashtu gjatë lehonisë e marrin pagën vetëm 70 % dhe në këtë aspekt janë të diskrimiuara.

Liburn Aliu- Tha se, pasi që kjo nuk është çështje politike, ne duhet të bisedojmë më MPMS. Raportin e hartojmë ne dhe nuk ndikohemi nga ta. Ne kemi të drejtë t'i ftojme në

Komision dhe të kërkojmë llogari nga ta. Është më mirë të diskutojmë me ta, sepse po të kalojë kjo çështje në seancë, atëherë miratimi i saj varet nga votat në seancë plenare.

Bahri Thaqi- Tha se qëndrimi i MPMS rreth nenit për pushimin e lehonisë është hipokrizi. Ata thonë se pushimi i gjatë ka ndikuar në dëmtimin e biznesit dhe rrjedhimisht ka ndikuar në rënien e punësimit të grave. Ne duhet ta mbrojmë familjen, lehonën dhe fëmijën.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka